



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ NR. 27, LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 70, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr.27, lirim dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 29, pika 5, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë me shkresën nr. 2488 prot., datë 23.04.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.27, Qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën dhe propozimin e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 172, datë 16.04.2019, plotësoi vakancën në KZAZ-në nr. 70, duke emëruar kryesisht në pozicionin e sekretarit kryesisht, z.Kelment Gavri. Me shkresën nr. 2559 prot., datë 26.04.2019 sekretari i emëruar kryesisht i KZAZ nr. 70, paraqet dorëheqjen për arsye objektive.



Nr. 216 i Vendimit Data 27.04.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 27, lirim dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

KQZ, bazuar në nenin 32, të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra sekretarin e emëruar kryesisht dhe plotëson vakancën duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, shtetasin që plotëson kushtet e nenit 30 dhe 31, për emërimin kryesisht sekretar i KZAZ nr. 70.

Pas emërimeve kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 70, rezulton se në listën e shtetasve të miratuar me vendim e KQZ nr. 140, datë 9.04.2019, shtetasit Bani Shkëlqim Jazxhi dhe Estela Qetsor Koli, me vendbanim në zonën zgjedhore Bashkia Devoll dhe me arsim juridik, figurojnë të pa emëruar nga KQZ. Plotësimi i vakancës së pozicionit të sekretarit të KZAZ nr. 70, do të kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 2/1 të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 11, neni 29, pika 5, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 27, sipas kërkesës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë anëtarin e KZAZ nr. 27, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.2.
3. Të lirojë sekretarin e emëruar kryesisht të KZAZ nr. 70, sipas lidhjes nr. 1.
4. Të emërojë kryesisht sekretarin e KZAZ nr. 70 sipas lidhjes nr. 2.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 216 i Vendimit Data 27.04.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 27, lirim dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.